



ARRESTOHET LEFTER KOKA

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Shqipëria me 'sytë' nga Sofja për hapjen e negociatave lojm i mirë nga Bullgaria: Ndryshojmë qëndrimin me Maqedoninë e Veriut



Vrasja në Tiranë, Jergen Duka u ekstradua në Itali dhe fitoi lirinë pas akuzave për trafik droge



Kantina e pijeve 3.4 milionë USD e Lefter Kokës objekt sekuestrimi nga SPAK, pasuria miliona euro e ish ministrit, lokale dhjetëra apartamente, dyqane dhe pronat



Vrasja në Tiranë, shoku i viktimës: Sherri nisi për rrahjen në market se kush do paguante i pari



I biri vrau gruan e kunate 2 vite më parë, i biri i Gazment Mustës: Të pezullohet dënimi me burgim të takoj nipërit



Kronikë

Ekzekutimi i biznesmenit në Laç, Report Tv zbulon dëshminë e 22-vjeçarit Lika në polici: Vrasjen e kam bërë unë se djemtë e tij më rrahën! Babai dhe shoku s'kanë lidhje

Dëshmia e dhënë në polici nga 22-vjeçari Llej Lika i cili sëbashku me babain e tij Skëndër Lika dhe shtetasin Klajdi Gjexhaj (Beleshi) u arrestuan një ditë më parë për vrasjen e biznesmenit Rakik Roli në Sanxhak të Kurbinit.



RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



Elvis Hila

12 Dhjetor, 12:53 | Përditësimi i fundit: 12 Dhjetor, 19:34



"Vrasjen e kam bërë unë dhe babai e shoku im nuk kanë asnjë lidhje me ngjarjen".

Kjo ka qenë dëshmia e dhënë në polici nga 22-vjeçari Llej Lika i cili sëbashku me babain e tij Skëndër Lika dhe shtetasin Klajdi Gjexhaj (Beleshi) u arrestuan një ditë më parë për vrasjen e biznesmenit Rakik Roli në Sanxhak të Kurbinit.



LEXO EDHE: Kërcet karrigia në Laç, kurbinasit dhe tifozët e Tiranës përleshën në tribunë (Video)

I riu ka thënë para hetuesve se vrasjen e ka kryer në shenjë hakmarrje, pasi djemtë e viktimës e kishin dhunuar barbarisht në muajin korrik të këtij viti.

Dy ditë pas ekzekutimit të biznesmenit Rakip Roli në Sanxhak të Kurbinit, policia ka arritur të **prangosë tre autorët** e dyshuar të ngjarjes. Në pranga kanë rënë babë e bir Skënder dhe Llej Lika si dhe Klaudio Beleshi. Ata u arrestuan nga forcat e policisë të komisariatit të Kurbinit, pasditen e së shtunës brenda një banese në zonën e Fushë-Milotit. Gjithashtu policia ka gjetur dhe sekuestruar dhe armen automatike me të cilën dyshohet se është kryer krimi si dhe automjetin me të cilin kanë lëvizur autorët.

Sipas të dhënave bëhet fjalë për një makinë tip "Benz" ngjyre gri i cili është kapur dhe nga kamerat e sigurisë të një biznesi në zonë 5 minuta pas atentatit me armë zjarri. Drejtues i mjetit mendohet të ketë qenë Klaudio Beleshi i cili i ka pritur babë e birë dhe i ka marrë e janë larguar sapo kanë kryer vrasjen .Ata kanë lëvizur në drejtim të Fushë-Miloti, duke u fshehur në banesën e një të afërmi të tyre, por falë reagimit të shpejtë të forcave policore të Komisarariatit të Kurbinin është arritur të zbulohet vendndodhja dhe prangosja e tyre.

Dinamika e vrasjes

Rakip Roli u qëllua me breshëri kallashnikovi sapo doli me makinë nga banesa e tij. Report Tv mëson se automjeti me të cilin udhëtonte viktimja, ka lëvizur për të paktën 500 metra nga vendi ku është qëlluar duke goditur nga pas një makinë tjetër tip 'Audi' ku më pas përfundoi në kanal. Biznesmeni është qëlluar nga krahu i pasagjerit me breshëri duke gjetur vdekjen e menjëhershme.

Kush ishte Rakip Roli?

Raportohet se Roli ishte biznesmen materialesh ndërtimi. Rakip Roli, rezulton emër i njohur për policinë. Në vitin 2011 ai u arrestua pasi u përfshi në plagosjen e një 22-vjeçari, ku së bashku me një person tjetër, Petrit Sana rrahën me sende të forta të riun, duke e plagosur rëndë, pas një sherri për motive banale.

Pista e hetimit

Hetimet janë përqendruar në konfliktet që mund të kenë pasur dy djemtë e biznesmenit Rakip Roli. Emiljano dhe Isuf Roli mësohet se **janë hetuar për trafik droge** në vitin 2017.

K.T./M.Ç/Shqiptarja.com

TAG: [Lezhe](#) [rakip roli](#)

Komento

Komente

Iris:

13/12/2021 01:03

Po per cfare drejtesi e vetegjyqesi flet?!A ia vlen qe nje rrahjeje t'i pergjigjesh me vrasje?!Dhe pervec kesaj,duket qe vrasesi nuk ka shkuar ne polici te ankohet qe e kane rrahur,perkundrazij ka rene shkurt duke perdorur kembezen ne vend te trurit(nese i ka mbetur ndonje cike) dhe ka vendosur te behet vete polic,gjykates dhe ekzekutor.Tani,veten e futi ne burg,po keshtu dhe babain e shokun dhe i hapi rruge gjakmarrjes,se dhe pala tjetere nuk kane me shume tru se ky birboja.Dhe sa per perpjekjen per te c'faqesuar babain dhe shokun,per mendimin tim eshte e kote.Vrasesi nuk vajti me pistolete,por me arme automatike.Babushi jo vetem qe e ka pare,por as qe e ka ndaluar ti thoshte :/Ndalo,cfare ke nder mend te besh,do marresh me qafe te tjeret,veten dhe neve!/.Perkundrazi, i ka thene ://Bjeri biri im.maskarait.vrite,se djemte e tij te moren nderin dhe burrerine!/.Dhe sa per shokun e tij,e dinte ose jo planin per vrasjen,mjafton qe ka qene shofer dhe i ka ndihmuar te arratisen,per te mos folur per mos denoncim krimi.Dhe kaq mjafton qe te mbyllet ne burg.

Përgjigju

www.youngtribune.com:

12/12/2021 20:35

Kur ska drejtesi njerezit do bejne vetgjygesji.

Përgjigju

Vin:

12/12/2021 18:49

O ti ton ton se me fjale qeke i mire po nuk jepen mendimet aq kollaj si i ben ti. Esht shum ndryshe teoria me praktiken Jeten ta jep zoti dhe mire esht te ta mare zoti

Përgjigju

Dritan:

12/12/2021 19:08

Vin ke te drejte ne keto qe thua po ja qe nuk eshte gjithmone keshtu.

Hitman:

12/12/2021 16:52

Parajsja jone Shqipnia dashtun ku asnje dite pa pune nuk mijna.Tash vazhdo saga forsajtive version Laqi killing fields gjithandaj. Hajt me hajer ket here se vec nji so bereqet. Ps kokat hengshin gjithje keto krijesa te ferrit dhe i rujt zoti kalimtare e pafajshem nga ndonje plumb qorr.

Përgjigju

Fshati Bog:

12/12/2021 14:13

Baba duhet cdo moment me ju shmang sherrit si kje i pasun si i varfen,por nodh nje fenomen shum i gabum sapo njeri ven do lek i hyp vedi ne qef,aty merr fun jeta jote aty prite mas qafe.Sot nuk rraheth burri ti menon se e injorove por sado koh te kalojn nuk ta fal kush asnje lloj moshe.Zoti u dhashte kivet familjarve.

Përgjigju

Ton Ton:

12/12/2021 13:18

22 vjec do kalbet mrena. Ta kishte majt baba krimin po qeka legen

Përgjigju

Amigo:

12/12/2021 16:16

Po ai si do dali ne rrug 22 vjec dhebi jati ne burg ??

Baba:


12/12/2021 15:26

Djali i ri eshte i ben ca vjet se gjen gje.. Dhe e nxjerr baba, por djali baben Se nxjerr dot nga burgu, duhet karakter Dhe pjekuri te merresh kto pune! Problemi eshte qe u hap nje hasmeri tjetere Ne shqiperine tone te dashur.

Jo me ton ton:

12/12/2021 14:48

Nuk osht ashtu si thua ti me dak. Babi duhet ta ndalonte krimin jam dakort. Por keta lloj ngasterash qe i hyn vetja ne qef e rrahin njerzit rrugeve perti vo vetes emer. Ka gjitmon nje fund te hidhur.. sepse burri shpreh dhe futyren nuk e shet kurre . Dhe ky djali osht 22 vjec se ka lon as sedra as fytyra me dal ne rruge me mbas rrahjes mendoj un.Keshtu kan dodhur ajo qe ndodhi . Te mosoj trimat tjere nga ky rast.



Ndaloheht repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

A rritet besimi juaj tek SPAK pas arrestimit të ish-ministrit Lefter Koka?

Po

Jo

Nuk e di

Lajme të tjera

Kultura



Përurohet busti i Monsinjon Zef Oroshit në Lezhë! Kleriku themelues i kishës 'Zoja e Shkodrës' në SHBA

14 Dhjetor, 13:57

Kronikë



Bëri drift me makinë dhe postoi videon në rrjete sociale! Në hetim 24-vjeçari në Lezhë! Policia i bllokoi makinën dhe i heq patentën për 2 vite

13 Dhjetor, 11:25

Sociale



Bien gurët e murit rrethues të kalasë së Lezhës, rrezikohen kalimtarët dhe banesat! Insituti i Trashgëmisë Kulturore për Report Tv: Nis restaurimi në 2022

13 Dhjetor, 11:20


Sociale



Moti i keq, stabilizohet situata në Lezhë! 100 ha tokë të përmbytura, niveli i ujit në rënie! Prugët nacionale të kalueshme pa probleme

13 Dhjetor, 10:54

Kronikë



Atentati ndaj Preng Palucës, gjendet banesa e njërit prej autorëve! Brenda, një pistoletë dhe disa mjete identifikimi

13 Dhjetor, 08:54

Kronikë



Dyshohen se vranë Kurbಿನ biznesmenit në Kurbin, arrestohen babë e bir

11 Dhjetor, 16:56